

## **PROCESVRBAL**

Nga seanca urgjente (e jashtëzakonshme) e Këshillit të Komunës së Bërvenicës, e mbajtur më 20.11.2024, (e mërkurë) me fillim nga ora 15:00 në ambientet e Komunës së Bërvenicës.

Të pranishëm: 10 këshilltarë.

Mungonin: Adem J. Jashari, Svetlana Stamatovska, Sinisha Jovanovski, Adem Jashari, Agnesa Zenuni, Daniela Gjordjevska

Seancën e hapi dhe e drejtoi kryetari i Këshillit, Bujamin Rushiti, i cili tha se ka kuorum për vendimmarrje të vlefshme nga numri i këshilltarëve të pranishëm.

Për punimin e seancës u propozua rendi i ditës në vijim.

### **Rendi I ditës**

1. Propozim-Vendim për përcaktimin e bashkëfinancimit të mjeteve financiare për rikonstruimin e rrugës „VËLLEZËRIT JANIQ, Fshati Bërvenicë- Komuna Bërvenicë.

Kryetari i Këshillit tha, votim rendin e ditës e hedh në votim dhe i njëjti miratua nga 9 këshilltarët e pranishëm.

### **I**

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës “Propozim-Vendim për përcaktimin e bashkëfinancimit të mjeteve financiare për rindërtimin e rrugës VËLLEZËRIT JANIQ, fshati Bërvenicë- Komuna e Bërvenicë”, të njëjtën lexoi Kryetari i Këshillit dhe fjalën e dha përgjegjësit nga komuna për të shpjeguar pikën.

Personi përgjegjës nga komuna tha se bëhet fjalë për rrugën Vëllezërit Janiq me gjatësi 446 m<sup>2</sup>, ky është vendimi ynë i dytë, janë bërë llogaritjet dhe si komunë po na financojnë me 652.128.00 mijë euro. Mjetet e shpenzuara janë 480.592.00 mijë euro, kurse na kanë mbetur edhe 162.528.00 mijë euro. Sipas përllogaritjeve të tyre, komuna duhet të bashkëfinancojë 25.000.00 mijë euro për realizimin e projektit “Vëllezërit JANIQ”. Është dashur të silllet në Këshill deri në fund të kësaj jave në mënyrë që të hapet një procedurë tenderimi.

Kryetari i Këshillit hapi diskutim .

Abeb Nuhii u paraqit për fjalë dhe tha, a nuk mjaftojnë këto mjete të mbetura për realizimin e projektit, a duhet ligjërisht të shtohen apo u duhen vërtet ato para.

Përgjegjësi nga komuna dhe tha se vetëm për 447 metra janë dhënë 480.592.00 mijë euro. Mbeten 162,528.00 mijë euro. Ne duhet të mbështesim pjesën tjetër. Kur të hapet tenderi do të shihet nëse do të tejkalohen këto mjete dhe çfarë oferte do të ketë. Tani për tani ata po kërkojnë një vendim nëse jeni dakord me këtë vendim.

Meqë askush tjetër nuk paraqit për fjalë, pika e rendit të ditës u hodh në votim “Propozim-Vendim për përcaktimin e bashkëfinancimit të mjeteve financiare për rikonstruimin e rrugës „VËLLEZËRIT JANIQ, Fshati Bërvenicë- Komuna Bërvenicë” dhe u pranua nga 9 këshilltarët e pranishëm.

Pas shterimit të pikave të rendit të ditës, përfundoi seanca Nga seanca urgjente (e jashtëzakonshme) e Këshillit të Komunës së Bërvenicës.

**Procesverbalist**  
Natasha Stojçeska  
**Përktheu,**  
Ferdane Idrizi,

**Nr.08-1570/2**  
**20.11.2024 viti.**  
**Bërvenicë**

**Kryetar I Këshillit ,**  
**Bujamin Rushiti**